

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Mars 2024

BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Mars 2024

AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në edicionin e këtij Buletini pasqyrohen
aktivitetet e KPK-së të muajit mars të vitit
2024)**

Mbahet Konferenca Vjetore e Forumit të Grave Gjyqtare dhe Prokurore

Prishtinë, 1 mars 2024

Trajtimi i çështjeve të rëndësishme për barazinë gjinore në sistemin gjyqësor dhe prokurorial dhe përfaqësimi gjinor në të gjitha nivelet e sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës, ishin tema diskutimi në Konferencën Vjetore të Forumit të Grave Gjyqtare dhe Prokurore, e cila zhvilloi punimet në tri sesione të ndara.



Më këtë rast, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Ardian Hajdaraj, theksoi se në Këshillin Prokurorial ekziston një angazhim i shtuar për rritjen e numrit të prokurorëve të gjinisë femërore, sidomos në këto katër vjetët e fundit kemi arritur rezultate të mira dhe në vitin 2021, numri i prokuroreve ka shënuar rritje për 43 për qind, gjë që është pasqyruar edhe në raportin e mbështetur nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë, me titull: “Vlerësimi institucional gjinor dhe përfshirja sociale e Prokurorisë së Kosovës”, kurse tashmë në krye të Këshillit Prokurorial, së bashku me mua, është edhe prokurorja znj.Jehona Grantolli, në detyrën e Zëvendëskryesues së KPK-së.

Gjithashtu, Zëvendëskryesuesja e KPK-së, znj.Jehona Grantolli, ka nënvizuar ndryshimin që është duke ndodhur sidomos me vendimet e fundit që në pozita të

rëndësishme të emërohen gra prokurore në sistemin prokurorial, në mënyrë që gratë të kenë rolin dhe pozitën legjitime dhe të kenë një avancim të mëtejshëm në procesin e fuqizimit të tyre në sistemin prokurorial.



Zëvendëskryesuesja e Forumit të Grave Gjyqtare dhe Prokurore, znj.Laura Pula, njëherësh Prokurore në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, ka theksuar rolin dhe rëndësinë e Forumit të Gjyqtareve dhe Prokuroreve, duke thënë se avancimi dhe fuqizimi i rolit të gruas në sistemin e drejtësisë është vizion i Forumit, por natyrshëm duhet të jetë edhe vizion institucional dhe shoqëror i vendit tonë.



Rrjedhimisht, gjatë konferencës së sotme, pjesëmarrësit diskutuan për arritjet dhe sfidat e Forumit të Grave Gjyqtare dhe Prokurore, perspektivat e grave juriste nga nivele të ndryshme të sistemeve gjyqësore dhe prokuroriale dhe për aktivitetet e vitit 2024 për shoqatat e reja të grave gjyqtare dhe prokurore.



Po sot, Forumi i Grave Gjyqtare dhe Prokurore është ndarë në dy forume të veçanta, me ç'rast janë mbajtur edhe zgjedhjet për të dyja forumet dhe pas votimit rezultoi që Prokuroria në ZKPSH, znj.Laura Pula, u zgjodh Kryetare e Forumit të Prokuroreve, kurse Gjyqtarja në Gjykatën Supreme, znj.Valdete Daka, u zgjodh kryetare e Forumit të Gjyqtarëve.

Fjalimi i Kyesuesit të KPK-së, z.Ardian Hajdaraj, në Konferencën Vjetore të Prokuroreëve

2 mars 2024

Në vijim gjeni fjalimin e Kyesuesit të KPK-së, z.Ardian Hajdaraj, në Konferencën Vjetore të Prokuroreëve:

I nderuari U.D. i Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi,

I nderuari Ambasador i SHBA-së, z. M.Hovenier,

I nderuari Shef i Zyrës së BE-së, Tomás Szunyog,

I nderuari Kryetar i Gjykatës Supreme, z.Fejzullah Rexhepi,

I nderuari Kryesues i Këshillit Gjyqësor, z. Albert Zogaj,

Të nderuar kolegë, anëtarë të Këshillit Prokurorial, kryeprokuror, prokurorë dhe të gjithë ju që jeni pjesë e sistemit prokurorial,

Të nderuar kryetarë të gjykatave dhe ju përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare,

Të nderuar përfaqësues të mediave shoqërisë civile,

Miq dhe ju mysafirë të nderuar



Ndihem i nderuar që kam rastin t'ju përshëndes në Konferencën Vjetore të Prokurorëve të Republikës së Kosovës.

Ka shumë pak kohë që jam zgjedhur në krye të Këshillit Prokurorial të Kosovës, edhe pse anëtarë i kësaj përbërjeje të Këshillit i kam mbi tri (3) vjet në përfaqësim të Prokurorisë Themelore në Pejë.

I falënderoj të gjithë kolegët për besimin e treguar ndaj meje.

Sot, kur bashkë me kolegët e tjerë anëtarë po e drejtojmë Këshillin drejt realizimit të mandatit kushtetues e ligjor kam filluar ta ndej peshën e drejtimit të Këshillit së bashku me të gjitha strukturat e tij.



Nga ajo kohë e deri më tani kemi kaluar nëpër shumë sfida dhe sot ju them juve, se ndihem krenar me punën e kolegëve të mi anëtarë të Këshillit Prokurorial, ndihem krenar me punën tuaj si prokurorë, me shërbimin e stafit të sistemit prokurorial dhe njëkohësisht jam i motivuar nga ndihma e të gjithë juve partnerë të sistemit prokurorial.

Mandati ynë si Këshill, fokusohet në mundësimin dhe sigurimin e kushteve sa më të mira, në mënyrë që ju si prokurorë të hetoni dhe ti ndiqni kryerësit e veprave penale më me efikasitet dhe me efektivitet ta përfaqësoni shtetin kundër çdo veprimi apo dukurie kriminale.

Ju siguroj, se pritjet tuaja në zbatim të përgjegjësive që i keni, janë prioritet absolut i planeve dhe strategjiive tona si Këshill Prokurorial dhe imi si kryesues i tij.

Më vjen mirë, që sot këtu mund ta them një gjë me siguri të plotë: ndër vite kemi arritur të sigurojmë numër më të madh të prokurorëve të rinj, është shpallur konkursi dhe së shpejti do të fillojmë rekrutimin 28 prokurorëve, 4 pozita prej të cilave janë të rezervuara për komunitetin serb. Kemi arritur të transferojmë dhe avancojmë numrin e nevojshëm të prokurorëve në nivele të ndryshme të prokurorisë, kemi vazhduar me vlerësimin e performancës dhe disiplinimin e prokurorëve. Gjithashtu Këshilli ka arritur të rekrutojë, pothuajse të gjitha pozitat e lira të personelit administrativ të parapara me planin vjetor të personelit.

Vlen të përmendet edhe fakti se jemi në proces që të përmbushim me sukses të gjitha obligimet tona të cilat dalin nga Deklarata e Zotimit për reformën ligjore në sistemin e drejtësisë, e nënshkruar në mes të Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Këshillit Prokurorial të Kosovës, Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurorit të Shtetit.

Meqenëse, kam qenë kryetar i Komisionit për Vlerësimin e Performancës për 3 vjet, tani si Kryesues e konsideroj të rëndësishme se për vlerësimin e performancës dhe efikasitetin tuaj më të lartë, puna kryesore është grumbullimi i përditshëm i burimeve faktike të informacionit dhe dorëzimi i tyre te eprori çdo vit dhe pastaj tek komisioni çdo 3 vite. Nëse bëhet kjo, do të arrihet të pasqyrohet performanca Juaj objektive dhe njëkohësisht arrihet obligimi i misionit të prokurorit për mbledhjen e provave. Aktualisht po punojmë për avancimin e sistemit të vlerësimit të performancës së prokurorëve me qëllim që të kemi prokurorë me integritet, dinjitet, profesional dhe të guximshëm. Me këtë rast kërkoj nga kryeprokurorët e prokurorive që të angazhohen në vlerësimin e drejtë të punës së secilit prokuror dhe së bashku të sigurojmë zbatimin e standardeve të larta të performancës, ndershmërisë dhe profesionalizmit.

Në bazë të kompetencës time, zotohem para qytetarëve tanë, se do të punoj fort në rritjen e transparencës përmes webfaqes së KPK-së, në dy shtyllat kryesore:

Sistemin e disiplinimit, me publikimin e vendimeve nga të gjithë autoritetet kompetente, duke mos cenuar të drejtat e garantuara me ligj dhe

Vlerësimin e performancës, me publikimin e menjëhershëm të vendimeve të Këshillit, duke përfshirë pikët dhe nivelet e vlerësimit të prokurorit, poashtu duke mos cenuar të drejtat e garantuara me ligj.

Gjithashtu në mënyrë të vazhdueshme kemi promovuar sistemin e zhvillimit të karrierës përmes transferimit dhe avancimit të prokurorëve aty ku ka më së shumti nevojë. Së shpejti përfundojmë një proces të avancimit me qëllim të forcimit të Prokurorisë Speciale.

Po punojmë në përmirësimin e infrastrukturës së prokurorive, në sigurimin e stafit të nevojshëm si dhe jemi duke ngritur koordinimin për organizimin e trajnimeve për prokurorë dhe personel me Akademinë e Drejtësisë.

Të nderuar të pranishëm,

Në rrugëtimin tonë po përballemi me sfida të shumta dhe nganjëherë edhe të vështira.

Ne ende kemi buxhet të pamjaftueshëm për të plotësuar nevojat e prokurorëve me stafin e duhur, ende kemi nevojë për një siguri më të madhe dhe kushte më të mira për punë, por të jeni të sigurt se të gjitha këto nevoja janë adresuar te institucionet kompetente dhe partnerët tanë, dhe kemi besim që ata do të na ndihmojnë për të arritur plotësimin e nevojave tona.

Synimet tona kryesore, ndër të tjera janë edhe përmirësimi i komunikimit, planifikimi më i mirë, llogaridhënia dhe transparencja. Këto dhe vlera të tjera janë pjesë e aktiviteteve tona të përditshme.

Në anën tjetër dëshiroj të ju them se edhe Këshilli Prokurorial ka pritur të shumta nga ju.

Mbi të gjitha, ne presim nga ju prokurorë që të punoni me përkushtim, të jeni të drejtë, të pavarur dhe profesional në kryerje të obligimeve tuaja. Ndërsa nga ju kryeprokurorë presim menaxhim me standardet më të larta, me koshienë dhe i cili mundëson qasje të drejtë në shërbimet e prokurorisë.

Të nderuar partnerë dhe ju miq të sistemit prokurorial,

Të arriturat dhe realizimi i vizionit tonë do të ishte i pamundur pa bashkëpunimin dhe mbështetjen e partnerëve tanë vendor dhe ndërkombëtar.

Ju falënderoj të gjithëve për mbështetjen.

Në këtë drejtim po theksoj ndihmën e dhënë nga projekte të ndryshme të Bashkimit Evropian, misionit të EULEX-it, Ambasadave, si ajo: Amerikane, Angleze, Norvegjeze, Holandeze dhe Franceze, pastaj ndihmën e madhe të UNDP-së, EUKOJUST, OSBE-së, GIZ-it, IRZ-së etj.

Këshilli Prokurorial çmon shumë edhe bashkëpunimin e institucioneve vendore, pa dashur të përmend me emra, por dua të shpreh gatishmërinë tonë për ngritjen e mëtejme të këtij bashkëpunimi.

Në fund, dëshiroj të ju falënderoj të gjithëve për kontributin tuaj në të kaluarën dhe presim bashkëpunimin e ndërsjellë edhe në të ardhmen.

Ju faleminderit!

Reagim i Këshillit Prokurorial të Kosovës për kërcënimin e bërë përmes rrjeteve sociale ndaj prokurores së Prokurorisë Themelore në Pejë, znj.Valbona Disha-Haxhosaj

Prishtinë, 4 mars 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka dënuar ashpër kërcënimin e bërë gjatë ditës së djeshme ndaj prokurores së Departamentit për Krime të Rënda në Prokurorinë Themelore në Pejë, znj. Valbona Disha-Haxhosaj, me anë të publikimit përmes rrjeteve sociale të një afisheje me përmbajtje mortore. Ky akt i shëmtuar, për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe tërësisht për sistemin prokurorial, është një akt i papranueshëm dhe i patolerueshëm, andaj KPK-ja bënë me dije se qëndron fuqishëm në përkrahje të prokurores Valbona Disha-Haxhosaj dhe ofron mbështetje të plotë për punën e saj gjatë ushtrimit të funksionit në ndjekjen e kryeseve të veprave penale.



KPK-ja njoftoi se janë duke u ndërmarrë masa konkrete për identifikimin dhe arrestimin e personit/ave, të cilët kanë vendosur këtë lajmërim të paskrupullt dhe të njëjtit do të dalin para organeve të drejtësisë dhe se institucionet e Prokurorit të Shtetit janë duke u trajtuar seriozisht këtë veprim penal dhe në nivelin e duhur të hetimit dhe të ndjekjes gjër në ndriçimin e plotë të tij, i cili ka për qëllim pengimin në ushtrimin e funksionit dhe detyrave të saja kushtetuese dhe ligjore.

KPK-ja siguroi opinionin publik se kërcënimet dhe shantazhet e tilla dhe veprime të tjera, çfarëdo qofshin ato, që bëhen ndaj prokurorëve të shtetit, nuk do t'i zmbarsin synimet dhe përpjekjet e vazhdueshme për fuqizimin e shtetit ligjor, në të cilin respektohen vetëm parimet e drejtësisë.

Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel

Prishtinë, 4 mars 2024

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës mbajti takimin e radhës sipas agjendës së paraparë.



Qëllimi i takimit ishte shqyrtimi i Planit të Personelit për vitin 2024 dhe shqyrtimi i krijimit të pozitave të reja si rrjedhojë e zbatimit të Rregullores për Organizmin e Brendshëm dhe Funksonimin e Prokurorit të Shtetit.

Anëtarët e Komisionit aprovuan Planin e Personelit për vitin 2024 dhe krijimin e pozitave të reja konform rregullores përkatëse.

Mbahet ceremonia e festimit të 8 Marsit

Prishtinë, 5 mars 2024

Zëvendëskryesuesja e Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), znj.Jehona Grantolli, e shoqëruar nga anëtarja e KPK-së, znj.Ariana Shajkovci, prokurorja në Prokurorinë Speciale, znj.Illiriana Çollaku-Tafa, zyrtaret nga OPDAT-i në Ambasadën Amerikane, znj.Benina Kusari dhe znj.Eliza Shporta, ka organizuar një ceremoni për shënimin e 8 Marsit –Ditës së Gruas, në të cilën morën pjesë prokurore nga prokuroritë e vendit, si dhe stafi profesional dhe administrativ i sistemit prokurorial.



Znj.Grantolli falënderoi të pranishmet në shenjë mirënjohjeje dhe respekti për punën dhe angazhimin e tyre në sistemin prokurorial, duke theksuar avancimin e rolit dhe të përgjegjësisë të grave dhe fuqizimin e mëtejshëm të tyre në rrugën që kemi përpara. “Kjo datë e sotme shënon një rrugëtim të vështirë dhe të gjatë shoqëror për të përmirësuar pozitën tonë dhe jetën tonë dhe përgjithësisht për të nxjerrë në pah vlerat tona si gra kontribuuese në sistemin e drejtësisë së vendit”, tha zonja Grantolli.

Me fjalë rasti janë paraqitur edhe anëtarja e KPK-së nga radhët e Prokurorisë Themelore në Prizren, znj.Ariana Shajkovci, prokuroret e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Iliriana Çollaku-Tafa dhe Fikrije Krasniqi-Fejzullahu, si dhe zyrtaret nga OPDAT-i në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, znj.Benina Kusari dhe znj.Edita Shporta, të cilat evokuan kujtime dhe folën mbi përvojat, sfidat, vështirësitë dhe arritjet e tyre, duke potencuar se 8 Marsi duhet të shërbejë jo vetëm për bashkimin e grave në mbrojtjen e të drejtave të tyre, por edhe për të përcjellë mesazhe të qarta institucionale dhe shoqërore për fuqizimin e tyre.



Dita Ndërkombëtare e Grave festohet më 8 mars çdo vit dhe përkujton lëvizjen për të drejtat e grave, ndërsa respektimi i parë i Ditës së Grave u mbajt më 28 shkurt 1909 në Nju Jork dhe 8 marsi u sugjerua nga Konferenca Ndërkombëtare e Grave për t’u bërë Ditë Ndërkombëtare e Grave.



Përgatitet lista përfundimtare me emrat e kandidatëve për anëtar të KPK-së nga radhët e PSRK-së

Prishtinë, 5 mars 2024

Komisioni për zgjedhjen e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) nga radhët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), i udhëhequr nga anëtari ioprokuror, z.Dardan Vuniqi, mbahti takim e radhës, në të cilin morën pjesë prokurori në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, z.Agron Qalaj dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, z.Sami Istrefi.



Në këtë takim janë shqyrtuar kandidaturat e të nominuarve për pozitën e anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe pas shqyrtimit të të njëjtave është përgatitur lista përfundimtare me emrat e kandidatëve të nominuar për këtë pozitë në sistemin prokurorial.

Anëtarët e Komisionit theksuan se pas finalizimit të listës së kandidatëve do të mbahen zgjedhjet, ashtu siç është paraparë, më 15 mars 2024.

Mbahet punëtori për finalizimin e draftit të Planit të Integritetit të sistemit prokurorial 2024-2026

Prishtinë, 7 mars 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), përmes mbështetjes së Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Kosovë, është duke mbajtur një punëtori dyditore për prezantimin dhe finalizimin e draftit të Planit të integritetit të sistemit prokurorial 2024-2026, plan ky, i cili derivon nga Ligji për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.



Në këtë punëtori janë duke marrë pjesë Kryesuesi i KPK-së, Ardian Hajdaraj, Zëvendëskryesuesja Jehona Grantolli, Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, anëtarë të Këshillit, prokurorë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, kryeprokurorë të prokurorive të vendit, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, përfaqësues të Institutit të Bazelit për Qeverisje dhe të UNDP-së dhe zyrtarët të tjerë të sistemit prokurorial.

Fillimisht, Kryesuesi i Këshillit, njëherësh kryesuesi i Grupit punues për hartimin e Planit të integritetit të sistemit prokurorial (2024-2026), Ardian Hajdaraj, prezantoi pjesët kryesore të planit, duke theksuar rëndësinë e madhe të këtij dokumenti të brendshëm, me anë të të cilit do të vlerësohet niveli i integritetit përbrenda secilit institucion përkatës dhe do të ofrohen një sërë masash për menaxhimin e tij në sistemin prokurorial.

Gjithashtu, në sesionin e parë të ditës së sotme, U.D.Kryeprokurori i Shtetit, Besim Kelmendi, foli për sigurimin efektiv të menaxhimit të integritetit, llogaridhënien dhe transparencën publike dhe parimet e rezistencës institucionale ndaj cenimeve të integritetit në sistemin prokurorial, duke vënë theksin në angazhimin e shtuar të të gjithëve për tejkalimin e sfidave dhe vështirësive të mundshme.

Edhe pjesëmarrësit e tjerë nënvizuan gjatë diskutimeve të tyre se, sot dhe nesër, në sesionet e radhës që do të mbahen në këtë punëtori, përmes këtij plani synohet rritja e mundësive për të arritur objektivat e menaxhimit të integritetit në pajtim me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale, në mënyrë që të arrihet besimi i stafit dhe i palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për zhvillimin dhe avancimin e integritetit, me anë të kontrolleve operative dhe fuqizimin e tyre në të gjitha aktivitetet dhe fushëveprimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe institucionit të Prokurorit të Shtetit.

Në sesionet e nesërme do të ketë diskutime përfundimtare për draftin si tërësi dhe do të trajtohen pyetësi gjithëpërfshirës dhe tabela e rrezikut, i cili

do të procedohet për miratim në njëhën nga takimet e radhës së Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Urimi i Kryesuesit Hajdaraj me rastin e festës së 8 Marsit

Prishtinë, 8 mars 2024

Me rastin e 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas, më lejoni që në emrin tim dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës t'ju dërgoj urimet më të sinqerta, duke vlerësuar lart përkushtimin tuaj në procese të shumta për zhvillimin, fuqizimin dhe avancimin e sistemit prokurorial.



Përmes këtij urimi të sotëm, shpreh përkrahjen institucionale për të drejtat e grave dhe për përfshirjen e tyre në mënyre të barabartë në vendimmarrje, duke vazhduar gjithnjë përpjekjet tona për barazi gjinore dhe arritjen e idealeve të synuara në të ardhmen.

Ta gëzoni festën!

Urimi i Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të KPK-së me rastin e festës së 8 Marsit

8 mars 2024

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, z.Sami Istrefi, me rastin e festës së 8 Marsit, ka uruar të gjitha



gratë, të cilat punojnë me profesionalizëm dhe përkushtim në sistemin prokurorial të Kosovës, si dhe ka shprehur falënderim të madh për kontributin e çmuar në kryerjen e përgjegjësiave të tyre.

Drejtori Istrefi, përmes këtij urimi, çmon lart angazhimin dhe shpreh mirënjohje për përkushtimin e përditshëm të secilës grua për të përmbushur detyrën e vet dhe për të bërë më të mirën për institucionet prokuroriale.

Të nderuara, gëzuar Ditën Tuaj!

Zhvillimi i kapaciteteve profesionale për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, temë diskutimi ndërmjet Kryesuesit Hajdaraj dhe Këshilltarit të Lartë për Çështje të Drejtësisë në INL, z.Michael Wasco

Prishtinë, 12 mars 2024

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z.Ardian Hajdaraj, i shoqëruar nga Zëvendëskryesuesja znj.Jehona Grantolli, ka pritur në takim përfaqësuesin e ekipit vlerësues të INL-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë, njëherësh Këshilltar i Lartë për Çështje të Drejtësisë në Zyrën Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) në Departamentin Amerikan të Shtetit, Michael Wasco dhe znj. Dafina Bardhi – Rexhepi, Specialiste e Programeve në INL në Ambasadën e SHBA-së në Kosovë.



Fillimisht, Kryesuesi Hajdaraj e njoftoi z. Wasco, për intensifikimin e angazhimit lidhur me realizimin e aktiviteteve të parapara për këtë vit dhe tejkalimin e sfidave të Këshillit Prokurorial, me ç'rast falënderoi z. Wasco, për mbështetjen e madhe të Programit për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatim të Ligjit (INL) në Kosovë, i cili fokusohet, ndër të tjera, edhe në përmirësimin dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të prokurorëve për luftën kundër korrupsionit dhe terrorizmit.

Nga ana tjetër, Këshilltari e Lartë Juridik në INL, Michael Wasco, falënderoi Kryesuesin Hajdaraj për pritjen, duke theksuar përkushtimin e mëtjshëm të INL-së për të ofruar ndihmë për luftimin e krimit të organizuar dhe sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.



Të dy bashkëbiseduesit u pajtuan gjatë diskutimeve që patën që të ketë bashkëpunim të shtuar në mes të KPK-së dhe INL-së sa i përket zbatimit të objektivave strategjike të sistemit prokurorial për zhvillimin e transparencës dhe llogaridhënies dhe për forcimin e një sistemi të pavarur prokurorial, duke siguruar që institucionet prokuroriale të jenë të lira nga ndërhyrjet politike dhe të përmbushin standardet e njohura ndërkombëtarisht.

INL, përmes Programit të Departamentit të Drejtësisë për Ndihmë, Trajnim dhe Zhvillim Prokurorial Jashtë Vendlind (OPDAT), mbështet trajnimin e prokurorëve, ofron ndihmë teknike, ndihmon në hartimin e legjislacionit, bën analiza ligjore dhe kontribuon në edukimin arsimor pasuniversitar, duke ofruar mbështetje për zhvillimin e institucioneve të sundimit të ligjit dhe të drejtësisë penale në Kosovë.

Adresimi me kohë i sfidave dhe zbatimi i objektivave të punës për vitin 2024, ishin në fokus të vizitës së kreut të Këshillit Prokurorial në Prokurorinë e Apelit dhe në Prokurorinë Themelore në Prishtinë

Prishtinë, 13 mars 2024

Në kuadër të iniciativës për t'i vizituar prokuroritë e vendlind, Kryesuesi i KPK-së, z.Ardian Hajdaraj dhe Zëvendëskryesuesja e KPK-së, znj. Jehona Grantolli, të shoqëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, z.Sami Istrefi, përveç Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Prokurorisë Speciale, kanë vizituar sot edhe Prokurorinë e Apelit dhe Prokurorinë Themelore në Prishtinë, me ç'rast janë pritur në takim nga kryeprokurorët e këtyre prokurorive, z. Xhevdet Bislimi dhe z.Zejnulla Gashi me bashkëpunëtorë.

Gjatë takimeve të zhvilluara, Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë, njoftuan udhëheqësit e Këshillit Prokurorial për proceset e punës në trajtimin e lëndëve, zbatimin e Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) dhe për nevojat e identifikuar konkrete të këtyre prokurorive në funksion të realizimit të mandatit të tyre kushtetues dhe ligjor.



Kryesuesi i Këshillit, z.Hajdaraj, tha se këto vizita realizohen në kuadër të nismës për t'u njohur nga afër

me aktivitetet dhe angazhimet konkrete, por edhe me sfidat, vështirësitë dhe nevojat e prokurorive të vendit, si dhe njëkohësisht duke konfirmuar edhe mbështetjen e nevojshme për fuqizimin dhe avancimin e procesit të punës në Prokurorisë së Apelit dhe në Prokurorinë Themelore në Prishtinë. “Adresimi me kohë i sfidave dhe zbatimi i objektivave të punës për vitin 2024 shpie drejt sukseseve tona të përbashkëta”, tha më këtë rast Kryesuesi Hajdaraj.



Në përfundim të takimeve të sotme në këto dy prokurori, Kryesuesi Hajdaraj dhe Zëvendëskryesuesja Grantolli, së bashku me bashkëbiseduesit e tyre, shprehën përkushtimin për bashkërendimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe për mbështetjen e gjithanshme për krijimin e parakushteve të punës, në mënyrë që të realizohen objektivat e punës për vitin 2024, të cilat do të ndikojnë në avancimin e përgjithshëm të sundimit të ligjit në Kosovë.

Vazhdojnë vizitat e Kryesuesit Hajdaraj nëpër prokuroritë e vendit, institucioni i radhës ishte Prokuroria Themelore në Pejë

Prishtinë, 13 mars 2024

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, vazhdoi edhe sot aktivitetet e parapara në kuadër të iniciativës për t’i vizituar prokuroritë e vendit, i shoqëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, z. Sami Istrefi, me ç’rast vizitoi Prokurorinë Themelore në Pejë, ku është pritur nga Kryeprokurori i kësaj prokurorie, z. Agim Kurmehaj, së bashku me bashkëpunëtorë.



Fillimisht, në takimin e zhvilluar në Pejë, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore, z. Agim Kurmehaj, njoftoi z. Hajdaraj për aktivitetet dhe proceset e zhvilluara të punës në tremujorin e parë të këtij viti dhe për sfidat dhe vështirësitë më të cilat përballet kjo prokurori në hetimin dhe ndjekjen e veprave penale në territorin që ka në kompetencë, i cili përbëhet nga katër komunitat përëndimore të Kosovës.

Kryesuesi Hajdaraj falënderoi për pritjen Kryeprokurorin Kurmehaj, duke theksuar se ka filluar vizitat nëpër prokuroritë e vendit për të parë nga afër zhvillimet e proceseve aktuale të punës dhe për të diskutuar nevojat konkrete të këtyre prokurorive për zbatimin e mandatit të tyre kushtetues dhe ligjor.

Në përfundim të takimit në këtë prokurori, z. Hajdaraj dhe z. Kurmehaj janë pajtuar për koordinimin e plotë të aktiviteteve të përbashkëta për zbatimin e planit të punës së kësaj prokurorie për vitin 2024 dhe rrjedhimisht edhe për angazhimin e Këshillit për krijimin e kushteve sa më të favorshme të punës, të cilat do të ndihmonin avancimin e sundimit të ligjit në këtë pjesë të vendit.

Miratohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2025-2027

Prishtinë, 14 mars 2024

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga prokurorja Ariana Shajkovci, mbajti takimin e radhës sipas agjendës së paraparë, në të cilin morën pjesë anëtarët e Komisionit, Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së dhe udhëheqëset e njësive organizative për buxhet dhe financa.



Qëllimi i takimit ishte shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2025-2027, dokument ky, i cili pas diskutimeve të zhvilluara është miratuar nga anëtarët e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel dhe do të dërgohet për miratim në njërin nga takimet e KPK-së.

Më këtë rast, u tha se për nevojat e sistemit prokurorial janë kërkuar 143 pozita të reja për vitin 2025, prej të cilave 38 pozita janë paraparë për prokurorë të rinj, kurse pjesa tjetër për stafin administrativ.

Krijimi i këtyre pozitave të reja vjen si rrjedhojë e zbatimit të rregulloreve të reja, me anë të të cilave parashihet fuqizimi i kapaciteteve njerëzore për realizimin efikas dhe efektiv të proceseve të punës në sistemin prokurorial.

Kryesuesi Hajdaraj priti në takim shefin e OSBE-së për Kosovë, Ambasadorin Michael Davenport dhe udhëheqësin e Sektorit për Ligj dhe Drejtësi, z.Mark Lasser

Prishtinë, 14 mars 2024

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z.Ardian Hajdaraj, së bashku me Zëvendëskryesuesen znj.Jehona Grantolli, ka pritur sot në takim Ambasadorin e Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) për Kosovë, z. Michael Davenport dhe shefin e Sektorit për Ligj dhe Drejtësi, z.Mark Lasser.



Qëllimi i këtij takimi ishte informimi i ndërsjellë për realizimin e projekteve të përbashkëta dhe mbajtja e vazhdimësisë së bashkëpunimit në mes të KPK-së dhe OSBE-së, me ç'rast Kryesuesi Hajdaraj falënderoi Ambasadorin Davenport për përkrahjen e vazhdueshme të OSBE-së për ngritjen dhe avancimin e kapaciteteve të përgjithshme të sistemit prokurorial.

“KPK-ja është e përkushtuar për të vazhduar bashkëpunimin me OSBE-në në çështjet e ngritjes së kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe stafit administrativ, me qëllim të avancimit të mëtejshëm të efikasitetit dhe efektivitetit gjatë proceseve të punës”, tha z.Hajdaraj.



Gjithashtu, diplomati britanik, Ambasadori Davenport, falënderoi Kryesuesin Hajdaraj për pritjen, duke nënvizuar se, misioni i OSBE-së në Kosovë është i gatshëm për të ofruar mbështetje për sistemin prokurorial, e cila vjen përmes ekipeve që kanë ekspertizë dhe përvojë në fushat e përkatëse të sistemit të drejtësisë, andaj mirëpresim punën në partneritet me Këshillin Prokurorial dhe Prokurorin e Shtetit.

Z. Hajdaraj dhe z. Davenport u pajtuan për organizimin dhe mbajtjen e programeve të trajnimit për prokurorë dhe për realizimin e projekteve të tjera me interes të përbashkët, për të cilat thanë se janë në

funkcion të forcimit të sundimit të ligjit në vend dhe do të realizohen sipas agjendave të parapara kohore.

KPK-ja dhe OSBE-ja në Kosovë bashkëpunojnë përmes projekteve të ndryshme, me qëllim të ngritjes së efikasitetit, efektivitetit, komunikimit me publikun dhe transparencës së sistemit prokurorial.

Mbahet procesi zgjedhor për anëtarë të Këshillit Prokurorial nga Prokuroria Speciale

Prishtinë, 15 mars 2024

Komisioni Zgjedhor nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), i Kryesuar nga Dardan Vuniqi dhe dy anëtarët, prokurori Agron Qalaj dhe Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Sami Istrefi, kanë mbajtur sot procesin zgjedhor për anëtarë të KPK-së nga radhët e Prokurorisë Speciale.



Në bazë të kompetencave ligjore, nga radhët e PS-së, nga 16 prokurorë sa ka kjo prokurori, të drejtën për t'u kandiduar për anëtar të KPK-së e kanë shfrytëzuar prokurorët Milot Krasniqi dhe Habibe Salihu.

Në këtë proces zgjedhor kanë marrë pjesë pesëmbëdhjetë (15) prokuror. Pas procesit të votimit Komisioni Zgjedhor konstaton se nga ky votim prokurori, Milot Krasniqi ka marr dhjetë (10) vota, ndërkaq prokurorja Habibe Salihu tre (3) vota, si dhe dy (2) vota të tjera shpallen të pavlefshme.



Komisioni Zgjedhor do të njoftoj Këshillin Prokurorial se nga ky proces i votimit, prokurori që ka marr më së shumti vota është Milot Krasniqi.

Procesi zgjedhor në Prokurori Speciale është zhvilluar pas përfundimit të mandatit të anëtares së KPK-së nga radhët e kësaj prokurorie, prokurores Merita Bina-Rugova.

Zëvendëskryesuesja e KPK-së, znj.Jehona Grantolli, pjesë e Konferencës “Zbatimi i Konventës së Stambollit përmes praktikës gjyqësore: Dialogu gjyqësor për një përgjigje gjyqësore efektive“

Prishtinë, 15 mars 2024

Zëvendëskryesuesja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, znj.Jehona Grantolli, ka marrë pjesë në Konferencën me titull “Zbatimi i Konventës së Stambollit përmes praktikës gjyqësore: Dialogu gjyqësor për një përgjigje gjyqësore efektive“, të organizuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës dhe Qendrën AIRE.



Gjithashtu, në konferencën e sotme kanë marrë pjesë përfaqësues të sistemit gjyqësor dhe prokurorial, Policisë e Kosovës dhe përfaqësues të autoriteteve qeveritare, organizatave ndërkombëtare, ambasadave dhe shoqërisë civile.

Fillimisht, një fjalë rasti mbajti Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Cakanimani, kurse ndër folësit kryesorë ishin Komisionerja për të Drejtat e Njeriut e Këshillit të Evropës dhe Kryetari i Bordit të Patronëve të Rrjetit Gjyqësor të Kampionëve të Çështjeve Gjinore dhe ish-Kryetari i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kurse në sesionin e dytë, në mesin e panelistëve ishte edhe prokurorja, njëkohësisht koordinatoeja për veprat

penale të dhunës në familje në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, znj. Sevdije Morina.



Në të dyja sesionet e mbajtura sot janë zhvilluar diskutime për zgjidhjet praktike të zbatimit të Konventës së Stambollit, përmirësimin e përgjigjes së sistemit të drejtësisë ndaj dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, si dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në mënyrë që të sigurohen masa efektive për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të këtyre krimeve.

Kryesuesi Hajdaraj priti në takim udhëheqësin e Ekipit për Sundim të Ligjit dhe të Drejta Themelore të Projektit EKOJUST, z.Nicola Scaramuzzo

Prishtinë, 15 mars 2024

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z.Ardian Hajdaraj, priti në takim udhëheqësin e Ekipit për Sundim të Ligjit dhe të Drejta Themelore të Projektit EKOJUST, z.Nicola Scaramuzzo.



Qëllimi i takimit ishte diskutimi i mbështetjes së mëtutjeshme për të përmirësuar efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve të sistemit prokurorial dhe për bashkërendimin e aktiviteteve të përbashkëta për

avancimin e transparencës publike dhe për përkrahje në fushën e teknologjisë informative, për të cilën kërkohet mbështetje financiare për të realizuar objektivat e parapara.

Kryesuesi Hajdaraj falënderoi udhëheqësin e Ekipit për Sundim të Ligjit dhe të Drejta Themelore, z. Scaramuzzo, për mbështetjen e Projektit EKOJUST në fushat e veprimeve të parashikuara gjatë vitit të kaluar dhe për muajt në vijim të vitit 2024, duke e njoftuar atë edhe për përgatitjen e akteve nënligjore që rrjedhin nga ligjet e reja, të cilat kanë hyrë në fuqi.

Z.Nicola Scaramuzzo falënderoi z.Hajdaraj për pritjen, duke theksuar ofrimin e mbështetjes me përkushtim nga ana e mekanizmave të Zyrës së BE-së në Kosovë, përmes mbështetjes dhe organizimit të aktiviteteve që kanë për qëllim fuqizimin e sundimit të ligjit.

Në takimin e sotëm, z. Hajdaraj dhe z. Scaramuzzo diskutuan edhe për zhvillimin e aktiviteteve të tjera konkrete të bashkëpunimit gjatë këtij viti, siç janë angazhimet për përdorimin e plotë të të dhënave në formë digjitale dhe ngritjen e cilësisë së tyre, duke kaluar nga raportet manuale në ato digjitale përmes SMIL-it dhe për ngritjen e mekanizmave për kontrollin e brendshëm.

Betohet anëtari i KPK-së nga radhët e shoqërisë civile dhe zgjidhet anëtari nga Prokuroria Speciale

Prishtinë, 19 mars 2024

Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti Takimin e 244-të me radhë, në të cilin diskutoi dhe miratoi pikat sipas rendit të ditës.



Që në fillim të takimit të sotëm dha betimin anëtari më i ri i Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e shoqërisë civile, i zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, Visar Krasniqi.



Të gjitha vendimet që u morën në takimin e sotëm janë si vijojnë, me ç'rast Këshilli i Prokurorial i Kosovës:

Miratoi nëntë (9) raporte vjetore të kryeprokurorëve të prokurorive të vendit për vitin 2023.

Miratoi Raportin vjetor për veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për vitin 2023.

Avancoi prokuroren Merita Kurtishi-Gaka nga Departamenti i Përgjithshëm në Departamentin për të Mitur të Prokurorisë Themelore në Prizren, e cila do të fillojë punën nga data 1 prill 2024.

Avancoi prokurorin Fatos Ajvazi nga Departamenti i Përgjithshëm në Prokurorinë Themelore në Prizren në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, i cili do të fillojë punën nga data 1 prill 2024.

Caktoi tre (3) anëtarë të Komisionit Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve me mandat trevjeçar, prokurorët si në vijim: kryetar Lulzim Sulejmani, anëtar Agron Qalaj dhe anëtare Sheribane Selimi-Muçaj, kurse anëtarë rezervë u caktuan prokurorja Laura Pula dhe prokurori Shkëlzen Ibrahim.

Miratoi Planin e personelit të sistemit prokurorial për vitin 2024, së bashku me rekomandimet e anëtarëve të KPK-së.

Miratoi Raportin vjetor të punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2023 dhe Planin i punës së Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2024.

Transferoi prokurorin e Prokurorisë së Apelit, Arben Ismajli, në Prokurorinë Speciale.

Shpalli konkurs të brendshëm për transferimin e gjashtë (6) prokurorëve në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe konkurs të brendshëm për avancim në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, konkurse këto, të cilat do të publikohen më 25 mars 2024.

Aprovoi dorëheqjen e prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Lulzim Aliu, kurse propozimi për lirim nga detyra do t'i dërgohet Presidentes së vendit.

Aprovoi kërkesën për lirim nga detyra të kryesuesit të Komisionit për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit, Aleksandër Lumezi dhe caktoi në vend të tij Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Zejnullah Gashi, kurse kryesues të Komisionit caktoi Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale, Blerim Isufaj.

Miratoi Raportin e Komisionit zgjedhor për zhvillimin e zgjedhjeve për anëtarin e KPK-së nga radhët e PSRK-së, duke zgjedhur njëkohësisht anëtarin e KPK-së nga radhët e Prokurorisë Speciale, Milot Krasniqi.

Refuzoi marrëveshjen vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore ndaj një prokurori në Prokurorinë Themelore në Prizren dhe riktheu rastin tek paneli hetimor.

Diskutohet ngritja e kapaciteteve të brendshme për administrimin e prokurorive

Prishtinë, 20 mars 2024

Në kuadër të bashkëpunimit në mes të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) dhe EUKOJUST-it, anëtari i KPK-së dhe njëkohësisht kryesuesi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive, z.Jetish Maloku, ka takuar sot ekspertin e EUKOJUST-it, z.Kristian Turkalj.



Me këtë rast, z.Maloku falënderoi ekspertin kroat të Projektit EUKOJUST, z.Turkalj, për vizitën e tij, duke thënë se padyshim që bashkëpunimi dhe mbështetja e EUKOJUST-it dhe ekspertëve të tij mbetet e rëndësishme në shumë drejtime, sidomos në aspektin e zbatimit të procedurave për ngritjen e kapaciteteve të brendshme dhe për administrimin e prokurorive, gjë që ndikon në luftimin e korrupsionit dhe sundimin e ligjit në Kosovë.

Nga ana tjetër, edhe z. Turkalj falënderoi për pritjen z.Maloku, duke nënvizuar se takimi i sotëm rezultoi me trajtimin e temave nga fushëveprimi i përbashkët, të cilat kanë të bëjnë me sundimin e ligjit në vendin tonë.

Në përfundim të takimit, bashkëbiseduesit potencuan se do të vazhdojnë me përkushtim aktivitetet e përbashkëta për forcimin e zbatimit të ligjit në Kosovë.

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së priti në takim ekspertët e Projektit britanik për fuqizimin e kapaciteteve dhe për mbështetjen e krijimit të ekipeve të përbashkëta hetimore kundër krimit të organizuar

Prishtinë, 20 mars 2024

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Sami Istrefi, priti në një takim udhëheqësin e Projektit për forcimin e policisë së udhëhequr nga inteligjenca dhe për mbështetjen e krijimit të ekipeve të përbashkëta hetimore kundër krimit të organizuar në Kosovë, ekspertin e fushës së krimit të organizuar, z.Mark McDowell dhe zyrtaren për zbatim të politikave në Sektorin e Sundimit të Ligjit në Ambasadën Britanike në Kosovë, znj.Altina Besimi.



Qëllimi i takimit ishte diskutimi i prioriteteve dhe i objektivave, që ndërlihen me angazhimin e përbashkët për fuqizimin e kapaciteteve të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, sidomos në aspektin e përmirësimit të ofrimit të shërbimeve gjatë proceseve të punës dhe për të ofruar ekspertizën profesionale për hartimin e procedurave standarde të punës.

Më këtë rast, Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së falënderoi përfaqësuesit e këtij projekti për vizitën e tyre, duke i njoftuar për prioritetet dhe objektivat që ndërlihen me funksionalizimin dhe avancimin e sektorit të administratës së Këshillit Prokurorial dhe institucionit

të Prokurorit të Shtetit. “Si gjithnjë, Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, përmes projekteve të saj, ka kontribuar për fuqizimin dhe avancimin e institucioneve tona, andaj mirëpresim bashkëpunimin e ri për ngritjen e kapaciteteve tona mbështetëse”, nënvizoi z.Istrefi.



Nga ana tjetër, përfaqësuesit e këtij projekti, falënderuan drejtorin për pritjen, duke theksuar se janë të përkushtuar dhe angazhohen në mënyrë intensive për të identifikuar çështjet me interes të përbashkët, përveç Prokurorisë Speciale, ku do të përkrahet sistemi prokurorial.

Në përfundim të takimit të sotëm, bashkëbiseduesit shprehën përkushtimin e tyre për të bashkëpunuar në kuadër të kompetencave përkatëse të tyre, në mënyrë që të ketë avancim të shërbimeve administrative me anë të implementimit të këtij projekti britanik në sistemin e drejtësisë në Kosovë, i cili implementohet nga Sustainable Criminal Justice Solutions or SCJS.

Reagim i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 21 mars 2024

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) njofton opinionin publik se grupi punues i sistemit prokurorial ka marrë pjesë në diskutimet e zhvilluara gjatë ditës së djeshme për draftet e dokumenteve që rrjedhin nga Deklarata e Përbashkët e Zotimeve në punëtorinë e Grupit punues për hartimin dhe finalizimin e legjislacionit të paraparë me këtë deklaratë.



Në këtë kontekst, KPK informon opinionin publik se në kundërshtim me Deklaratën e Përbashkët të Zotimit të institucioneve të drejtësisë, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë (MD) nuk i kanë sjellë konkluzionet e punëtorisë së kaluar në punëtorinë treditore, e cila është duke u mbajtur për hartimin dhe finalizimin e legjislacionit që rrjedh nga kjo deklaratë dhe s'i kanë marrë parasysh rekomandimet e përfaqësuesve të sistemit prokurorial, ashtu siç janë marrë vesh në punëtoritë e mbajtura më parë.

Fillimisht, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë kërkuan të diskutohet një draft i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në të cilin kishte rekomandime të MD-së, të cilat nuk ishin diskutuar më parë dhe nuk ishin as pjesë e raportit përmbledhës të grupit punës, kurse anëtarët e grupit nga sistemi prokurorial kanë kundërshtuar, sepse nuk kishin autorizim për të diskutuar diçka që nuk kishte kaluar paraprakisht në KPK.

Me këtë rast, përfaqësuesit nga KPK-ja dhe ZKPSH-ja kërkuan shpjegime edhe për mungesën e konkluzioneve, por Zëvendësministri i Ministrisë së Drejtësisë, Vigan Qorrolli, në mënyrë tendencioze kishte fyer ata, duke iu thënë se do të kërkojë nga KPK-ja që të mos dërgojnë gjithkënd në takime të tilla, ku nga KPK-ja janë deleguar katër përfaqësues dhe një nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit. Pas kësaj përfaqësuesit e sistemit prokurorial kanë braktisur punëtorinë.

KPK-ja thekson se kjo është qasje denigruese, e padinjitetshme dhe mosbashkëpunuese nga ana e përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë, prandaj bënë thirrje që të ndryshojnë qasjet e tilla, sepse s'i kontribuojnë frymës së bashkëpunimit ndër-institucional dhe, KPK-ja, nënvizon se është e përkushtuar dhe do të angazhohet në mënyrë intensive për të punuar, mbrojtur dhe avancuar çdo vlerë që fuqizon sundimin e ligjit në vend.

Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së priti në takim ekspertët e projektit “Përmirësimi i trajtimit të personave të privuar nga liria” të Zyrës së Këshillit të Evropës

Prishtinë, 21 mars 2024

Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Sami Istrefi, priti në një takim ekspertët dhe zyrtarët e projektit “Përmirësimi i trajtimit të personave të privuar nga liria” të Zyrës së Këshillit të Evropës, në përbërje të të cilit ishin

Konsulentin Ndërkombëtar të Këshillit të Evropës, z.Marco Hokkanen, Eksperti Lokal, z.Alban Muriqi, Zyrtari i Lartë i Projektit, z.Arben Lubach dhe Zyrtarja e Projektit, znj.Majlinda Jashanica.

Qëllimi i takimit ishte për të diskutuar për mundësitë e bashkëpunimit për zbatimin e këtij projekti të Këshillit të Evropës dhe për perspektivën e çështjes së bashkëpunimit ndërmjet partnerëve të projektit dhe kreut të administratës së sistemit prokurorial të Kosovës.



Drejtori Istrefi, duke falënderuar mysafirët për vizitën e tyre në krye me Ekspertin Ndërkombëtar të Këshillit të Evropës, z.Marco Hokkanen, theksoi se mirëpret bashkëpunimin në kuadër të aktiviteteve të këtij projekti dhe rekomandimet e misionit vlerësues për metodologjinë e punës dhe bashkëpunimin e partnerëve të projektit.

Me këtë rast, edhe Konsulenti Ndërkombëtar, z.Hakkonen, falënderoi drejtorin Istrefi për pritjen, duke thënë se ky mision vlerësues ishte i nevojshëm për të diskutuar për bashkëpunimin midis partnerëve të projektit dhe për t'u njohur me gjendjen aktuale, ngeçjet, sfidat dhe mundësitë e përmirësimit nga perspektivat e dyanshme.



Në përfundim të takimit, z.Istrefi dhe z.Kakkonen u pajtuan për shkëmbimin e informacioneve për nevojat e misionit vlerësues katërditor të projektit, projekt i

Zyrës së Këshillit të Evropës në Kosovë, i cili bashkëfinancohet nga Këshilli i Evropës, Belgjika, Gjermania, Irlanda dhe Norvegjia.

Ky projekt ka filluar në tetor të vitit 2022 dhe do të vazhdojë zbatimin deri në fund të shtatorit të vitit 2025.

Kryesuesi Hajdaraj, pjesë e delegacionit që takoi Ndihmës Sekretarin Amerikan për Byronë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL), z.Todd D. Robinson

Prishtinë, 21 mars 2024

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Ardian Hajdaraj, së bashku me Zëvendës Kryesuesen znj.Jehona Grantolli dhe Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, z.Blerim Isufaj, ishte pjesë e delegacionit të përbashkët të sistemit të drejtësisë që priti në takim Ndihmës Sekretarin Amerikan për Byronë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL), z.Todd D. Robinson.



Në Pallatin e Drejtësisë, ku u zhvillua takimi i sotëm ishin të pranishëm përfaqësuesit nga Ambasada Amerikane në Prishtinë dhe përfaqësues të sistemit gjyqësor.

Me këtë rast, zyrtarët e lartë të institucioneve të drejtësisë diskutuan me Ndihmëssekretarin Robinson për reformat e sundimit të ligjit në Kosovë, me ç'rast u prezantuan edhe kërkesat e përfaqësuesve të sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor, përfshirë respektimin e ndarjes së pushteteve dhe moscenimin e pavarësisë dhe profesionalizmit të institucioneve të drejtësisë në Kosovë.

Ndër temat e tjera që u diskutuan, ishin edhe përballja me sfidat e korrupsionit dhe nevoja për reforma ligjore

për të luftuar trafikimin me narkotikë, duke zbatuar standardet dhe praktikat evropiane, si dhe duke ngritur llogaridhënien, efikasitetin dhe transparencën publike.



Në fjalën e tij, Ndihmëssekretari Robinson, nënvizoi rolin dhe rëndësinë e bashkëpunimit mes Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Republikës së Kosovës, duke kërkuar angazhim të shtuar për forcimin e sundimit të ligjit dhe avancimin e shtetit të së drejtës në Kosovë.

Kryesuesi Hajdaraj: Zbatimi i projekteve të tilla me përmasa globale është i nevojshëm për drejtësinë penale në shoqërinë tone

Prishtinë, 25 mars 2024

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z.Ardian Hajdaraj, i shoqëruar nga kryetari i Komisionit për Çështje Normative, z.Armend Zenelaj, priti në takim përfaqësuesit e Projektit "Zgjidhjet e qëndrueshme në drejtësinë penale - SCJS", z.Essie Adair dhe z.Chris Reid. Këta ekspertë nga Irlanda Veriore në fushën e krimit të organizuar shoqëroheshin nga Zyrtarja për zbatimin e politikave në sektorin e sundimit të ligjit në Ambasadën Britanike, znj.Altina Besimi dhe eksperti vendor, z.Ardian Bajraktari.



Siç u tha në fillim të takimit, ekspertët britanikë, z.Adair dhe z.Reid, angazhohen për avancimin e efikasitetit, efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së sistemeve të drejtësisë penale në nivel global, kurse qëllimi i takimit të sotëm ishte diskutimi i objektivave të projektit, veprimet e parashikuara gjatë vitit 2024 dhe rezultatet e pritshme pas zbatimit të tij.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Ardian Hajdaraj, falënderoi ekspertët për angazhimin e tyre konkret dhe i njoftoi për të arriturat dhe sfidat aktuale në sistemin prokurorial, si dhe për planin e hartimit të akteve nënligjore që rrjedhin nga ligjet e reja dhe mundësinë e përkrahjes me anë të ekspertizës së tyre. “Vlerësoj se zbatimi i projekteve të tilla me përmasa globale është i nevojshëm për drejtësinë penale në shoqërinë tonë”, tha me këtë rast z.Hajdaraj.




Nga ana tjetër, z.Essie Adair, falënderoi Kryesuesin e KPK-së për pritjen dhe konfirmoi përkushtimin e ekipit të projektit që do të zbatohet përmes mbështetjes dhe organizimit të aktiviteteve.

Z.Hajdaraj dhe ekspertët britanikë janë pajtuar që të intensifikojnë aktivitetet e përbashkëta, në mënyrë që të shkëmbehen përvojat dhe praktikat më të mira globale, të cilat fuqizojnë drejtësinë penale dhe përgjithësisht sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës.

Miratohet Plani i punës së Komisionit për Çështje Normative për vitin 2024

Prishtinë, 25 mars 2024

Komisioni për Çështje Normative, i kryesuar nga z.Armend Zenelaj, mbajti takimin e radhës sipas agjendës së paraparë, në të cilin morën pjesë anëtarët e tij, z.Bahri Hyseni dhe z.Illir Morina, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, z.Sami Istrefi,



zyrtaret nga OPDAT-i në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, znj.Benina Kusari dhe znj.Edita Shporta dhe U.D.Udhëheqësi i ZMNV-së, z.Burhan Maxhuni.

Fillimisht, anëtarët e këtij komisioni miratuan Planin e Punës së Komisionit për Çështje Normative për vitin 2024, i cili bazohet në Planin Strategjik të Sistemit Prokurorial dhe përmban aktivitetet që do të realizohen në periudhën e ardhshme njëvjeçare.



Gjithashtu, pas trajtimit final, miratuan edhe draftin e Rregullores për Mandatin, Strukturën dhe Funkcionimin e Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave (ZMNV), me ç'rast, kryesuesi i Komisionit, z.Zenelaj, falënderoi edhe partnerët ndërkombëtarë për mbështetjen që kanë dhënë lidhur me draftimin e kësaj rregulloreje, e cila do të dalë në dëgjim publik edhe më pas do t'i propozohet për miratim Këshillit Prokurorial.

Komisioni diskutoi edhe autorizimin e kryesuesit të KPK-së për rishikimin dhe ndryshimin e Rregullores për Zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës, si dhe plotësim ndryshimin e saj.

Mbahet takimi i parë i Komisionit për rekrutimin e 28 prokurorëve të rinj të Shtetit

Prishtinë, 26 mars 2024

Komisioni për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit i



Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), i kryesuar nga Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Blerim Isufaj, mbajti një takim informues, në të cilin morën pjesë anëtarët e tij: Ardian Hajdaraj, Jehona Grantolli, Armend Zenelaj dhe Zejnulla Gashi, si dhe Drejtori i Përgjithshëm i SKPK-së, Sami Istrefi, Drejtoresha e NJSHPP-së, Arta Kelmendi dhe menaxherët të tjerë të stafit administrativ.

Qëllim i këtij takimi ishte trajtimi i hapave të mëtuqeshëm të procesit të rekrutimit të njëzetetë (28) prokurorëve të rinj të shtetit në prokuroritë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në Rregulloren Nr.02/2022 për Rekrutimin, Provimin, Emërimin dhe Riemërimin e Prokurorëve të Shtetit.

Gjatë takimit të sotëm, u tha se ky proces do të kalojë nëpër të gjitha fazat e parapara rekrutuese dhe do të realizohet sipas standardeve të avancuara ndërkombëtare, kurse Këshilli Prokurorial i Kosovës do t'i mbajë mediat dhe opinionin publik të informuar në vazhdimësi lidhur procedurat dhe procesin e përzgjedhjes së prokurorëve të rinj.

Procesi i rekrutimit të prokurorëve të rinj ka filluar me shpalljen e konkursit më 22 shkurt 2024 dhe kandidatët kanë pasur mundësi të aplikojnë përmes katër formave: sistemit online, dorëzimit të kopjeve fizike, me e-mail dhe postë të rregullt.

Mbahet takimi i parë i Komisionit Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve

Prishtinë, 27 mars 2024

Në kuadër të zbatimit të Rregullores 01/2023 për Komisionin Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve, Komisioni Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve i



Këshillit Prokurorial të Kosovës, i caktuar nga ana e KPK-së dhe që kryesohej nga prokurori në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Lulzim Sulejmani, ka mbajtur takimin e parë sipas agjendës së paraparë, në të cilin morën pjesë edhe anëtarët Agron Qalaj dhe Sheribane Selimi-Muçaj, si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së, Sami Istrefi dhe Koordinatorin e Komisioneve të Përhershme të KPK-së, Besim Kusari.

Prërdhimisht, në takimin e sotëm, anëtarët e këtij komisioni trajtuan procedurat për dhënien e opinionëve dhe diskutuan për çështjet e angazhimit konkret për funksionalizmin sa më të shpejtë të këtij trupi institucional, përfshirë fillimin e vlerësimeve dhe respektimin e afateve të parapara ligjore dhe nënligjore për dhënien e opinionëve përkatëse.



Me këtë rast është diskutuar për zbatimin e transparencës publike nga ana e Komisionit Këshillëdhënës për Etikën e Prokurorëve në KPK, edhe përmes krijimit të hapësirës së veçantë në faqen zyrtare të Këshillit, ku do të publikohen opinionet e ndryshme, të nxjerra gjatë proceseve të punës.

Mbahet takimi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Prishtinë, 27 mars 2024

Komisioni për Administrimin e Prokurorive të KPK-së, i udhëhequr z.Jetish Maloku, ka mbajtur takimin e radhës, sipas agjendës së paraparë, në të cilin morën pjesë anëtarët e këtij komisioni, Koordinatori i Komisioneve të Përhershme të KPK-së, zyrtarët e



Departamentit të Teknologjisë Informative të Sekretariatit të KPK-së dhe të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë.

Fillimisht është bërë prezantimi i Raportit për vlerësimin dhe verifikimin e kushteve të punës në objektet e sistemit prokurorial, raport ky, i cili është aprovuar nga anëtarët e Komisionit, në të cilin janë evidentuar sfidat dhe problemet që janë aktualisht në shumicën e objekteve prokuroriale, me ç'rast u tha se në këtë fazë do të kenë prioritet objektet e Këshillit Prokurorial, Prokurorisë së Apelit dhe Prokurorisë Themelore të Prishtinës.



Po ashtu janë trajtuar edhe kërkesat për avancimin e SMIL-it, të cilat parashohin zhvillimin e raporteve statistikore, avancimin e shkëmbimit elektronik në mes të prokurorive dhe gjykatave themelore, si dhe realizimin e ndërlidhjes së Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Gjykatës Supreme.

Kryesuesi i Komisionit për Administrimin e Prokurorive, z.Jetish Maloku, njoftoi anëtarët se, në bashkëpunim me

projektin e CEPEJ-it është duke u diskutuar organizimi i një punëtorie, në të cilën do të prezantohen të dhënat e raporteve statistikore sipas rekomandimeve të ekspertëve të CEPEJ-it dhe plani kohor për zëvendësimin e raporteve manuale me ato elektronike që gjenerohen nga SMIL-i.

Betohet anëtari i KPK-së nga radhët e Prokurorisë Speciale

Prishtinë, 29 mars 2024

Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti Takimin e 245-të me radhë.



Në fillim të takimit të sotëm ka bërë betimin anëtari më i ri i Këshillit Prokurorial të Kosovës nga radhët e Prokurorisë Speciale, Milot Krasniqi.

